

VENDIM
Nr. 44, datë 22.1.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 719, DATË 13.12.2023, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 11, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, dhe të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastruktursë dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikat 3 dhe 4, të vendimit nr. 719, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave, vlera “... 133 968 072.50 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë ...” zëvendësohet me “... 133 945 087.5 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e tetëdhjetë e shtatë pikë pesë) lekë ...”.

2. Të dhënat e numrit rendor 1, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, “PËR NJË NDRYSHIM NË VKM NR. 719, DATË 13.12.2023 “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 11, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS”, BASHKIA TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM DHE/OSE KOMPENSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË			VLERA TOTALE (lekë) Kompensim në vlerë	KONFIRMUAR/SHËNIME	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas	Lloji i pas.	Sip. Truall/Arë Totale m²	Shpronësim tokë "truall"					
								Sip e prekur (m2)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)			
PRONE PRIVATE													
1	Nysret		Haxhija	8320	1/136	Truall	2,335.0	2,335.0	22,985.0	53,669,975.00	53,669,975.00	Konfirmuar nga ASHK	
	Sait		Fani										

VLERA TOTALE (lekë) Kompensim në vlerë	2,335.0	2,335.0			53,669,975.00	
--	---------	---------	--	--	---------------	--